



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 26 shtator 2025, në mbledhjen e XXXVIII-të (tridhjetetetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi, kurse mungoi Lirika Maliqi), lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje nga Ekzekutivi i Komunës i pranishëm ishte Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa DBF.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit përfshirë drejtorin e DBF-së z.Fatlum Osmani, Zyrën Ligjore të Komunës dhe zyrtarin e IT të cilët asistojnë në organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, konstatoi kuorumin ku prezent ishin të gjithë përveç zonjës Lirika Maliqi, ndër të tjera theksoi, pra kemi 2 pika të rendit të ditës të cilat sigurisht i keni lexuar dhe analizuar gjatë kësaj kohe prej se ju është dërguar thirrja dhe materiali i mbledhjes.

Andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës kështu siç është.

Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 29.07.2025

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë procesverbal sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, u konstatua se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 29.07.2025

2. Propozim Vendimi për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikime buxhetore 2027-2028

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, fillimisht më lejoni që të paraqes për rekomandim dhe miratim në seancën e Kuvendit të Komunës projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe projeksionet buxhetore për vitet 2027-2028, material të cilin sigurisht që e keni marrë me kohë andaj edhe nuk po dëshiroj të zgjati shumë gjatë.

Do të thotë buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2026 që është prej 34,778,954.00 € i cili është ndarë në bazë të Qarkoreve Buxhetore 2026/01 dhe 2026/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kështu që ju ftoj ta mbështetni që të kaloj tutje për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës që është caktuar të mbahet nesër më 29.09.2025.

z.Haki Rudari, theksoi, miratimi i buxhetit të Komunës është një prej dokumenteve më të rëndësishme që është kompetencë e Kuvendit të Komunës, andaj në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë miratim në këtë mbledhje të KPF-së dhe rekomandojmë që të kaloj në seancën e Kuvendit të Komunës dhe sigurisht që në mbledhjen e Kuvendit natyrisht që do t'i japim mbështetje këtij buxheti për të cilin siç u tha përfshinë projekte dhe investime në sektorë apo Drejtori të ndryshme, andaj konsideroj se çdo investim që bëhet nëpër këta sektorë natyrisht që përkrahet apo ka efekt të drejtpërdrejtë te qytetarët.

z.Naim Çunaku, theksoi, duke i nisë nga fakti që tani po miratojmë kjo përbërje e legjislativit gjegjësisht e këtij Kuvendi, mbi 4 vite miratojmë buxhete komunale dhe nuk do të doja kur sot që jemi në përfundimin e këtij mandati të shfaqim ato vërejtjet të cilat i kemi paraqitur për 3 vite radhazi, por duke parë krejt këtë situatë të krijuar që në një formë jemi në një lloj fushate zgjedhore, vërejtjet sugjerimet dhe se a do të jemi mbështetës të buxhetit apo jo, sigurisht që sot në këtë mbledhje të KPF-së ka mbështetjen tonë që të kaloj në mbledhjen e Kuvendit dhe pastaj në Kuvend sigurisht se do ta japim kontributin tonë qoftë për, qoftë kundër, qoftë me vërejtje qoftë me sugjerime qoftë për pëlqime.

z.Bashkim Sylja, theksoi, siç jeni në dijeni unë nuk jam pjesë e garës politike edhe për një mandat të ardhshëm në asamblenë komunale, kështu që e shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për bashkëpunimin secilin prej juve dhe gjithashtu t'ju kërkojë falje secilin prej juve në rast se pa qëllim e kam lënduar ndonjëherë gjatë këtij rrugëtimi tim.

Sa i përket propozim vendimit për buxhetin e Komunës edhe unë jam për që ky projektbuxhet të kaloj në seancën e Kuvendit dhe sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet tona do t'i japim në mbledhjen e Kuvendit që është caktuar të mbahet nesër.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk kam gjetur shumë kohë të shfletoj dhe analizoj materialin por paksa në vija të trasha e kam shikuar dhe po shfrytëzoj rastin të pyes drejtorin e DBF-së sepse sa mbaj mend kur e kemi shqyrtuar Kornizën Afatmesme Buxhetore totali i buxhetit ka qenë mbi këtë shumë që është tani në projektbuxhet, pra ka qenë mbi 35 milion euro, kurse tani sa kam parë ishte nën 35 milion euro.

Po ashtu disa investime që janë premtuar disa herë në të kaluarën i pash edhe në këtë projektbuxhet, edhe pse nuk e kam lexuar krejt në detaje, por pash që në 2-3 buxhete janë përmend 100,000.00€ për një sallë të Kuvendit e që nuk e pash se a janë sërish ato mjete, ndërsa për tjerat investime dhe projekte besoj që së shpejti do të hulumtoj dhe të shikoj se çka kanë bërë në këtë projektbuxhet, por më shumë më interesoj a është zvogëluar buxheti shkaku i numrit të banorëve apo përse nuk është shifra e njëjtë me atë të KAB-it.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, buxheti për vitin 2026 është i njëjti në qoftë se e krahasojmë me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe është një rritje nga viti 2025, mirëpo çështja është që rritja e pagave ka determinuar në kategoritë tjera se përndryshe si tërësi kemi rritje të buxhetit.

Sa i përket sallës së Kuvendit që u përmend, ne e kemi në plan të prokurimit edhe në këtë vit dhe është në fazën e projektimit dhe ka mbet që duhet të realizohet nga të hyrat vetanake që do të barten nga viti 2025 në vitin 2026 e që trendi ka bërë të kemi rritje të të hyrave vetanake dhe pastaj që ka mundësi nga të hyrat vetanake të iniciohet si projekt.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk është se kam qenë aq mirë me matematikë i nderuar drejtor, mirëpo i nderuar drejtor unë e kam parë që në projeksionet e KAB për vitin 2026 shuma e buxhetit është 35,074,116.00€, kurse në këtë projektbuxhet tani kemi shumë 34,778,954.00€, do të thotë rreth 300,000.00€ më pak, kështu është nëse veç unë e kam vërejtur mirë këtë çështje, edhe pse nuk është se e kam analizuar në detaje këtë projektbuxhet siç e thash edhe në fillim por me sa pash në vija të trasha ishte kjo ndër të tjerat që e ceka që në krahasim me KAB ku buxheti ka qenë mbi 35 milion euro tani me projektbuxhet kemi nën 35 milion euro, rreth 300,000.00€ më pak, dhe pyetja ishte pse.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendi për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje duke theksuar që edhe kjo mbledhje e cila sipas të gjitha gjasave është e fundit në këtë mandat andaj të gjithë atyre që janë në garë i'u uroj suksese. Pra faleminderit të gjithëve.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0062558/25
Podujevë,
26 shtator 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**